

LIGJ I TRANSFERIT TE NEPUNESVE ADMINISTRATIVE TE PUNESUAR NEPERMJET PROGRAMIT K-5 NE MINISTRINE E SISTEMIT POLITIK DHE MARRREDHENIEVE NDERMJET BASHKESIVE

Neni 1

Me kete ligj rregullohet procedura per mobilitet nepermjet transferit te nepunesve administrative te pasistemuar nga Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrredhenieve Ndermjet Bashkesive, te punesuar nepermjet programit te perfaqesimit adekuat dhe te drejte, Programi K-5 (ne tekstin e metutjeshem: te punesuarit), ne organet e pushtetit shteteror dhe lokal dhe ne organet e tjera shteterore te themeluara ne pajtim me Kushtetuten dhe me ligjin dhe ne institucionet te cilat kryejne veprimtari nga sfera e arsimit, shkences, shendetesise, kultures, punes, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes se femijes, sportit, si dhe ne veprimtari te tjera me interes publik te percaktuar me ligj, por te organizuara si agjenci, fonde, institucione publike dhe ndermarrje publike te themeluara nga Republika e Maqedonise se Veriut ose nga komunat, nga qyteti i Shkupit, si dhe nga komunat ne Qytetin e Shkupit.

Ky ligj i perfshin te punesuarit te cilet kane themeluar marrredhenie pune perfundimisht me 31 dhjetor 2019.

Neni 2

Per proceduren e transferit te te punesuarve sipas nenit 1 te ketij ligji zbatohen dispozitat e ketij ligji dhe rregullat e miratuara ne baze te ketij ligji.

Per ceshtjet te cilat nuk jane rregulluar me kete ligj, por qe kane te bejne me te drejtat sipas marrredhenies se punes se te punesuarve sipas nenit 1 te ketij ligji, zbatohen Ligji i Nepunesve Administrative, Ligji i te Punesuarve ne Sektorin Publik, ligje te tjera te vecanta dhe dispozitat e pergjithshme per marrredhenie te punes, nese nuk jane ne kundërshtim me dispozitat e ketij ligji.

Neni 3

Transferi nepermjet sistemimit te te punesuarve sipas nenit 1 te ketij ligji zbatohet ekskluzivisht me dispozitat e ketij ligji.

Transferi sipas paragrafit 1 te ketij neni behet nepermjet sistemimit te te punesuarit ne vendin e punes ne nivel te njejte, perkatesisht ne vendin e punes per te cilin i punesuari i ploteson kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te percaktuara ne aktin e sistematizimit te vendeve te punes ne institucionin ne te cilin sistemohet ose transferohet.

Neni 4

(1) Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrredhenieve Ndermjet Bashkesive, me se voni 15 dite pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut i propozon plan per transferin e nepunesve administrative te pasistemuar nga Ministria te punesuar nepermjet programit K-5 (ne tekstin e metutjeshem: Plani i transferit).

(2) Plani i transferit sipas paragrafit (1) te ketij neni permban: te dhena personale per te gjithe te punesuarit sipas nenit 1 te ketij ligji, te cilet duhet te transferohen dhe te sistemohen, te dhena per nivelin e vendit te punes te punesimit rrjedhes, te dhena per arsimin e fituar, si dhe emrin e institucionit ne te cilin transferohet i punesuari.

(3) Gjate pergatitjes dhe dorezimit te Planit te transferit sipas paragrafit 1 te ketij neni do te zbatohen dispozitat per mbrojtjen e te dhenave personale.

- (4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me se voni 30 dite nga hyrja në fuqi e këtij ligji e miraton Planin e transferit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
- (5) Organi kompetent për buxhetin e institucionit në të cilin transferohen të punësuarit jep pëlqim për planin sipas paragrafit (1) të këtij neni.
- (6) Në bazë të Planit të transferit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve Ndermjet Bashkësive për çdo të punësuar përgatit aktvendim për udhëzim të përhershëm.
- (7) Aktvendimin sipas paragrafit (6) të këtij neni Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve Ndermjet Bashkësive të punësuarit ia dorezon personalisht.
- (8) I punësuarit në afat prej shtatë ditësh pas marrjes së aktvendimit sipas paragrafit (6) të këtij neni nënshkruan deklaratë për pranimin e aktvendimit për udhëzim të përhershëm.
- (9) Të punësuarit, i cili nuk do të nënshkruajë deklaratën sipas paragrafit (8) të këtij neni, i pushon vendi i punës në Ministrinë e Sistemit Politik dhe të Marrëdhënieve Ndermjet Bashkësive dhe evidentohet në transfer – listen për transfer të mundshëm të Ministrisë së Shqërsisë Informatike dhe të Administratës.
- (10) Në bazë të Planit të transferit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, institucionet sipas nenit 1 të këtij ligji miratojnë vendim për sistemimin e të punësuarve të cilët kanë nënshkruar deklaratë në pajtim me paragrafin (8) të këtij neni.

Neni 5

Personat udhëheqës në institucionet sipas nenit 1 të këtij ligji, janë të detyruar ta fillojnë procedurën e harmonizimit të akteve për sistematizim në vendet e punës me dispozitat e këtij ligji në afat prej 30 ditësh nga miratimi i Planit të marrjes sipas nenit 4 të këtij ligji.

Neni 6

Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve Ndermjet Bashkësive, pas transferit të të punësuarve, do të miratojë ndryshim të aktit për sistematizim në vendet e punës në drejtim të harmonizimit me nevojat e Ministrisë.

Neni 7

Gjore në shumë prej 2000 euro në kundërvlerë me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në institucionin nëse nuk i harmonizojnë aktet për organizim të brendshëm dhe aktet për sistematizim të vendeve të punës në pajtim me nenin 5 të këtij ligji.

Neni 8

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji kryen organi i administratës, kompetent për sigurimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetarëve, të cilët ju perkasin të gjitha bashkësive në organet e administratës shtetërore.

Neni 9

Me datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet dispozita sipas nenit 42 paragrafi (3) e Ligjit të të Punësuarve në Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 27/14, 199/14,

27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numer 143/19 dhe 14/20).

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi me datën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, dhe do të zbatohet deri në datën e përfundimit të plotë të procedurës së transferit të nepunësve administrativë nga Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive të Punësuar nëpërmjet Programit të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë, Programit K-5.